



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/118


Datë: 30.11.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 30 nëntor 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohen ekstraktet e procesverbaleve dhe transkripteve nga mbledhjet 112, 113 dhe 114 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/118

Datë: 30.11.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 30 nëntor 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet me vërejtje Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës.
2. Obligohet Zyra Ligjore në Zyrën e Kryeministrit në konsultim me Ministrinë e Administratës Publike për përfshirjen e vërejtjeve në tekstin e Projektligjit nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/118


Datë: 30.11.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 30 nëntor 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Rregullorja për Menaxhimin Financiar të Fondit për Sigurime Shëndetësore.
2. Obligohet Ministria e Shëndetësisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Rregullores nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/118


Datë: 30.11.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 30 nëntor 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Udhëzimi Administrativ për Kompetencat, Përgjegjësitë, Kriteret dhe Procedurat për Emërimin dhe Shkarkimin e Zëvendësdirjtorëve në Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror.
2. Obligohet Ministria e Infrastrukturës dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Udhëzimit nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/118

Datë: 30.11.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, duke shqyrtuar kërkesën e Presidentit të Republikës së Kosovës të datës 24.11.2016, në mbledhjen e mbajtur më 30 nëntor 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Komisionit Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Dëshmorit të Kombit, Invalidit, Veteranit, Pjesëtarit apo të Internuarit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të cilit i ka përfunduar mandati me 20.05.2016 sipas vendimit nr. 04/87 datë 13.05.2016, i vazhdohet mandati deri me 23 dhjetor 2016, duke llogaritur nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
2. Detyrë e Komisionit nga pika 1. e këtij vendimi është shqyrtimi i aplikacioneve për kategorinë e Dëshmorëve të Kombit të UÇK-së, të mbetura pa u shqyrtuar në mandatin paraprak të këtij Komisioni.
3. Obligohet Komisioni nga pika 1. e këtij vendimi që deri më datë 23 dhjetor 2016 ta përfundojë punën sipas pikës 2. të këtij vendimi, ndërsa Zyra për Çështje të Kategorive të dala nga Lufta e UÇK-së, në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, t'i ofrojë mbështetje administrative Komisionit.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave;
- të gjitha ministrave;
- Kryesuesit dhe anëtarëve të Komisionit;
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës;
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/118

Datë: 30.11.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 21 të Ligjit Nr. 03/L-175 për Borxhet Publike, të nenit 8 paragrafi 6. të Rregullores QRK-Nr. 22/2013 mbi Procedurat për Emetimin dhe Menaxhimin e Borxheve Shtetërore, Garancive Shtetërore dhe Borxheve Komunale, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 30 nëntor 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

Marrëveshja e Garancisë për FSDK - Linja e dytë Kreditore për Fondin për Sigurimin e Depozitave të Kosovës

1. Aprovohet propozimi i Ministrisë së Financave për Marrëveshjen e Garancisë për FSDK - Linja e dytë Kreditore për Fondin për Sigurimin e Depozitave të Kosovës.
2. Pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, Dokumenti i Garancisë Shtetërore duhet të nënshkruhet në emër të Republikës së Kosovës nga Ministri i Financave.
3. Obligohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi, konform Ligjit Nr. 03/L-175 për Borxhet Publike.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/118


Datë: 30.11.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 7 paragrafi 5. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, të nenit 18 paragrafi 1.6. dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 30 nëntor 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet propozimi i Ministrisë së Financave për t'i rekomanduar Presidentit të Republikës së Kosovës për autorizimin e Ministrit të Financave për nënshkrimin e Marrëveshjes së Garancisë për FSDK - Linja e dytë kreditore për Fondin e Sigurimit të Depozitave të Kosovës.
2. I rekomandohet Presidentit të Republikës së Kosovës për dhënien e autorizimit për nënshkrimin e marrëveshjes nga paragrafi 1. e këtij vendimi, konform afatit të përcaktuar në Ligjin për Marrëveshjet Ndërkombëtare.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/118


Datë: 30.11.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 30 nëntor 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet me vërejtje Statuti i Fondit të Sigurimeve Shëndetësore.
2. Obligohet Zyra Ligjore në Zyrën e Kryeministrit në konsultim me Ministrinë e Shëndetësisë për përfshirjen e vërejtjeve në tekstin e Statutit nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Obligohet Ministria e Shëndetësisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/118

Datë: 30.11.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 29 të Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, duke iu referuar kërkesës me nr. protokollin 3563 të datës 24.11.2016, në mbledhjen e mbajtur më 30 nëntor 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në vlerë 20,000.00 (njëzet mijë euro), për Autoritetin Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, lidhur me obligimet që dalin nga pjesmarrja në procesin e dialogut.
2. Mjetet financiare sipas pikës 1. të këtij vendimi ndahen nga Shpenzimet e paparashikuara, nën-programi Shpenzimet e paparashikuara me kod 13100, kategoria e rezervës, dhe transferohen në Autoritetin Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (235) në nën-programin me kod 11323, në kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime.
3. Obligohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë